

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

**Pasqyrat Financiare Individuale
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013**

Permbajtja:

	Faqe
Opinioni i Audituesit te Pavarur	1
Pasqyra individuale e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013	2
Pasqyra individuale e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013	3
Pasqyra individuale e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013	4
Pasqyra individuale e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013	5
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare individuale	6 - 13

Opinion i Audituesit te Pavarur

Drejtuar aksionereve te Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale te Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a. ('Shoqeria') te cilat perbehen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013, pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve ne kapital, pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013, si dhe nje permbledhje te politikave kontabel dhe informacione te tjera shpjeguese.

Pergjegjesia e menaxhmentit per pasqyrat financiare

Menaxhmenti i Shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe prezantimin e drejte te pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi, si dhe per procedurat e kontrollit te cilat menaxhmenti i konsideron te domosdoshme per pergatitjen e pasqyrave financiare pa anomali te rendesishme me baze gabimi ose mashtrimi.

Pergjegjesia e audituesit

Pergjegjesia jone eshte te shprehim opinionin tone mbi keto pasqyra financiare bazuar mbi procedurat tona te auditimit te kryera ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Per shkak te ceshtjes qe pershkruhet ne *Bazen per refuzim dhenie opinionit*, ne nuk ishim ne gjendje te merrnim evidence te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te mbeshtetur opinionin tone si auditues.

Baza per refuzim dhenie opinionit

Gjate viteve 2008 – 2012, dhe kryesisht gjate vitit 2008, Shoqeria ka marre financime nga pale te treta te cilat paraqiten ne pasqyren e pozicionit financiar te Shoqerise, dhe konkretisht ne shenimin 7 dhe 8, me vlere totale 8,615,991,523 Leke, e cila perfaqeson 42% te totalit te detyrimeve te Shoqerise apo 71% te aktiveve neto te Shoqerise me 31 dhjetor 2013. Per shkak te moshes se vjeter te ketyre financimeve, si dhe mungeses se dokumentacionit mbeshtetes te tilla si kontrata financimi dhe akte rakordimi dhe konfirmimi, ne nuk ishim ne gjendje te percaktojme me procedura alternativa nese shumat e treguara si detyrime ndaj paleve te treta jane te sakta apo kane nevoje per rregullime, si dhe efektin e ketyre rregullimeve ne pasqyren e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013, dhe te te ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshimeve ne kapital dhe flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013.

Refuzim dhenie opinionit

Per shkak te rendesise se ceshtjes se pershkruar tek *Baza per refuzim dhenie opinionit*, ne nuk kemi gene ne gjendje te marrim evidence auditimi te mjaftueshme dhe te pershtatshme mbi te cilen te bazojme opinionin tone si auditues, dhe prandaj, ne nuk shprehim opinion mbi keto pasqyra financiare.



Laura Qorllaze
Ekspert Kontabel Regjistruar
23 tetor 2014

Avanntive Consulting sh.p.k.

Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, kati 5/4, Tiranë, Shqipëri; Tel: +355 42 268 079 / 268 219; Faks: +355 42 268 219;

Email: avanntive@avanntive.al; Web Site: www.avanntive.al

Regjistruar me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 31 janar 2011 me NUIS L11331002K

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Pasqyra individuale e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

	Shenime shpjeguese	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktivet			
I. Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,510,737	29,403
Kerkesa per t'u arketuar	5	2,000,000	2,000,000
Totali i aktiveve afatshkurtra (I)		3,510,737	2,029,403
II. Aktivet afatgjata			
Investime	6	8,299,572,550	15,939,250,000
Totali i aktiveve afatgjata (II)		8,299,572,550	15,939,250,000
Totali i aktiveve (I,II)		8,303,083,287	15,941,279,403
Detyrimet dhe kapitali			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Huamarrje - pjesa afatshkurter	7	8,966,721,136	4,636,063,419
Detyrime per t'u paguar	8	7,897,816,523	7,414,286,999
Detyrime te tjera		1,730,603	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		16,866,268,262	12,050,350,418
II. Detyrimet afatgjata			
Huamarrje - pjesa afatgjate	7	3,491,975,860	7,214,423,261
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		3,491,975,860	7,214,423,261
Totali i detyrimeve (I,II)		20,358,244,122	19,264,773,679
III. Kapitali			
Kapitali themeltar	1	3,500,000	2,000,000
Fitimi (humbja) e akumuluar		(3,325,494,276)	(2,787,945,156)
Fitimi (humbja) e vitit		(8,733,166,559)	(537,549,120)
Totali i kapitalit (III)		(12,055,160,835)	(3,323,494,276)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		8,303,083,287	15,941,279,403


Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Pasqyrat individuale financiare te Shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013 u aprovuan nga Keshilli Mbikqures me 30 shtator 2014 dhe u nenshkruan nga administratori si me poshte:

Edvin Pine

Edvin Pine

Administrator



Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.
Pasqyra individuale e te ardhurave dhe shpenzimeve
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

	Shenime shpjeguese	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2012
I. Te ardhura			
Te ardhura nga aktiviteti		-	-
Totali i te ardhurave (I)		-	-
II. Shpenzime			
Shpenzime personeli	9	(1,938,706)	-
Zhvleresimi i investimit	6	(7,639,677,450)	-
Shpenzime te tjera		-	(553,681)
		(7,641,616,156)	(553,681)
III. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Shpenzime interesi dhe komisioni, neto	10	(1,063,189,929)	(232,887,268)
Fitime (humbje) nga kurset e kembimit, neto	11	(28,360,474)	(304,108,171)
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto (III)		(1,091,550,403)	(536,995,439)
Fitimi (humbja) para tatimit (I-II-/+III)		(8,733,166,559)	(537,549,120)
Tatim-fitimi	12	-	-
Fitimi (humbja) neto e periudhes		(8,733,166,559)	(537,549,120)

Pasqyra individuale e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.
Pasqyra individuale e ndryshimeve ne kapital
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

	Kapitali themeltar	Rezeve ligjore	Fitimi (humbja) e akumuluar	Totali
Pozicioni me 1 janar 2012				
Kontribut ne kapital	2,000,000	-	(2,787,945,156)	(2,785,945,156)
Fitimi (humbja) e vitit	-		(537,549,120)	(537,549,120)
Pozicioni me 31 dhjetor 2012	2,000,000	-	(3,325,494,276)	(3,323,494,276)
Kontribut ne kapital	1,500,000			1,500,000
Fitimi (humbja) e vitit			(8,733,166,559)	(8,733,166,559)
Pozicioni me 31 dhjetor 2013	3,500,000	-	(12,058,660,835)	(12,055,160,835)

Pasqyra individuale e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.
Pasqyra individuale e flukseve monetare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

	Shenime shpjeguese	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit			
Fitimi para tatimit		(8,733,166,559)	(537,549,120)
Rregullime per:			
Shpenzime nga interesat	10	1,063,159,218	232,791,898
Zhvleresimi i investimeve	6	7,639,677,450	-
Fitime (humbje) nga kurset e kembimit,	11	(454,948,902)	(19,481,317)
neto			
Rritje (Ulje) ne detyrimet per t'u paguar		473,146,160	553,681
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		(12,132,633)	(323,684,858)
Interesa te paguara		-	158,775,000
Tatim mbi fitimin i paguar		-	-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e shfrytezimit (I)		(12,132,633)	(164,909,858)
II. Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit			
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e investimit (II)		-	-
III. Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit			
Financime te marra nga pale te treta	7,8	12,113,967	164,831,291
Kontribut ne kapital	1	1,500,000	-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit (III)		13,613,967	164,831,291
IV. Rritja (Ulja) neto i mjeteve monetare (I,II,III)		1,481,334	(78,567)
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	4	29,403	107,970
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes		1,510,737	29,403

Pasqyra individuale e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

1. Informacion i pergjithshom

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a. (referuar si "Shoqeria" ose "AMRA") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si shoqeri anonime me date 2 korrik 2008 dhe me Degen e Tatimeve dhe Taksave, Tirane, me NIPT K81902013T.

Ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit, aktiviteti i Shoqerise konsiston ne importin, eksportin e karburanteve dhe nenprodukteve te tyre, perpunimin e naftes dhe nenprodukteve te saj, si dhe shlye me pakice te karburanteve te te gjitha llojeve.

Ndryshimet ne strukturen aksionere

Shoqeria u themelua fillimisht per realizimin e blerjes se 85% te aksioneve te shoqerise ARMO sh.a., nje shoqeri shqiptare e zoteruar 100% nga qeveria shqiptare perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes ne vijim te procesit te privatizimit te organizuar nga kjo e fundit.

Aksioneret e Shoqerise fillimisht ishin tre shoqeri te huaja, si me poshte:

- Anika Enterprises SA, nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Zvicres, zoteruese e 70% te aksioneve te AMRAs;
- Refinery Associates of Texac, Inc., nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Shteteve te Bashkuara te Amerikes, zoteruese e 20% te aksioneve te AMRAs;
- Mercuria Energy Trading B.V., nje shoqeri e themeluar sipa ligjeve te Mbreterise se Holandes, zoteruese e 10% te aksioneve te AMRAs.

Me 19 nentor 2008, aksioneri Mercuria Energy Trading B.V. largohet duke ia shitur aksionet aksionerit kryesor, Anika Enterprises SA, perqindja zoteruese e te cilit rritet ne 80% te aksioneve.

Me 6 gusht 2013, aksioneri kryesor Anika Enterprise SA i shet aksionet e saj tek shoqeria Heaney Assets Corporation, nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Ishujve te Virgjjer Britanike. Me 31 dhjetor 2013, Shoqeria zoterohet nga dy shoqeri te huaja, si me poshte:

- Heaney Assets Corporation, zoteruese e 80% te aksioneve te AMRAs;
- Refinery Associates of Texac, Inc., zoteruese e 20% te aksioneve te AMRAs.

Me 31 dhjetor 2013, vlera e kapitalit themeltar eshte 3,500,000 Leke, e ndare ne 2,000 kuota me vlere nominale 1,750 Leke per kuote.

Drejtimi i Shoqerise

Perfaqesuesi ligjor dhe drejtuesi i Shoqerise eshte Z. Edwin Pine. Deri me 31 dhjetor 2013, perfaqesuesja ligjore dhe drejtuesja e Shoqerise ka qene Znj. Cindy Lalleman.

Veprimtaria e Shoqerise monitorohet nga Keshilli Mbikqyres, i cili ne daten e aprovimit te ketyre pasqyrave financiare, perbehet nga:

- | | |
|--------------------------------|---------|
| 1. Z. Nazim Mustafayev | Kryetar |
| 2. Z. Vladimir Nickels | Anetar |
| 3. Z. John Lamb Davidson | Anetar |
| 4. Znj. Valerie Strecker | Anetare |
| 5. Z. Joselh Melton Desormeaux | Anetar |

Adresa e Shoqerise eshte ne Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, kati 8, zyra 1, Tirane, Shqiperi.

Me date 31 dhjetor 2013 Shoqeria ka 1 te punesuar (2012: 0).

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave

2.1 Perputhshmeria

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006 ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 te ndryshuar me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

Bazuar ne SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 4, Shoqeria ka zgjedhur te mos kontabilizojë tatimet e shtyra ne pasqyrat financiare individuale per periudhen qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

Keto pasqyra financiare individuale u aprovuan nga Keshilli Mbikqyres me 30 shtator 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike me perjashtim te rasteve kur percaktohet ndryshe, nese ka te tilla.

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme jane klasifikuar per t'i bere ato te krahasueshme me paraqitjen e te dhenave te periudhes ushtrimore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne vecanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare individuale.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, pervec rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Investime ne shoqerite e kontrolluara

investimi ne shoqerine e kontrolluar ARMO sh.a. eshte paraqitur ne keto pasqyra financiare individuale mbi bazen e metodes se koston. Ai eshte njohur fillimisht me koston, dhe me pas eshte zhvleresuar per te reflektuar vleren e realizueshme te investimit. Humbja nga zhvleresimi eshte kaluar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kosto e investimit perfshin te gjitha koston e transakcionit.

3.2 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transakcionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transakcionit ndersa ato qe maten me vleren e drejte rikembihen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aktiveve dhe detyrimeve monetare ne mone dhe te huaj jane:

	<u>31 dhjetor 2013</u>
Euro/Leke	140.20
Dollar Amerikane/Leke	101.86

3.3 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga kerkesa per t'u arketuar, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, detyrime per t'u paguar.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar, perfshire dhe huate e dhena, njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Te ardhurat nga interesi mbi huate afatgjata njihet duke u bazuar ne interesin efektiv. Provigjoni per zhvleresimin e kerkesave per t'u arketuar llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Detyrimet per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra

Huate e marra njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periodhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodës se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

Vlera e drejte

Nuk ka dallime te rendesishme midis vleres se drejte te parave dhe ekuivalenteve te saj, kerkesave per t'u arketuar, detyrimeve per t'u paguar dhe huave te marra dhe te dhena, dhe vleres se tyre kontabel ne daten e raportimit.

3.4 Zhvleresimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivete financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivete e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te ngjashme te rrezikut.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, njihet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivete financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivete jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Perfitimet e punonjesve

Fondet e sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe pensione

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, Shoqeria eshte e detyruar te paguaje ne emer te punonjesve te saj kontribute te detyrueshme ne nje fond social te menaxhuar nga shteti. Pagesat dhe detyrimet e mbuluara nga Shoqeria njihen si shpenzime ne periudhen te ciles ato i perkasin.

3.6 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.7 Njohja e te ardhurave

Shitja e mallrave

Te ardhurat nga shitja e mallrave gjate rrjedhes normale te biznesit maten me vleren e drejte te shperblimit te marre, duke zbritur kthimet e mundshme te mallrave, zbritjet tregtare dhe rabatet. Te ardhurat njihen atehere kur rreziqet dhe perfitimet e rendesishme jane transferuar tek blesesi, marrja e shperblimit eshte e sigurt, koston perkatese si dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te vleresohen

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

ne menyre te besueshme, nuk ka perfshirje te shitesit ne menaxhimin e mallrave, si dhe shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri.

Shitja e sherbimeve

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave ne varesi te fazes se perfundimit te transakcionit ne daten e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

3.8 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursit i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes, i cili njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te periudhes, duke perdorur normat tatimore te miratuara ne periudhen e raportimit.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2013 jane si me poshte:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari rrjedhese		
Leke	1,499,071	6,079
Euro	8,822	16,779
Dollare	2,844	6,545
Totali	1,510,737	29,403

5. Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesa per t'u arketuar me 31 dhjetor 2013 ne shumen 2,000,000 Leke perfaqeson kapitalin e regjistruar te papaguar nga aksioneret e Shoqerise para ndryshimit te pronesise me 6 gusht 2013.

6. Investime ne shoqerite e kontrolluara

Shuma e investimeve ne shoqerite e kontrolluara me 31 dhjetor 2013 perfaqeson pronesine e Shoqerise ne 85% te aksioneve te ARMO sh.a. Me 31 dhjetor 2013, investimi ne kapitalin e ARMO sh.a. eshte zhvleresuar per shumen 7,639,677,450 Leke, per te reflektuar humbjet e realizuara nga kjo e fundit deri me 31 dhjetor 2013.

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

7. Huamarrje

Huate e marra me 31 dhjetor 2013 jane si me poshte:

	% e Interesit	Afati	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Pjesa afatshkurter:				
Interesa ndaj IBA			790,463,508	196,353,216
Interesa per pagesa te vonuara ndaj IBA			453,375,880	31,424,769
Hua bankare ndaj IBA - pjesa afatshkurter	8%	3 vjet	7,722,881,748	4,408,285,434
			8,966,721,136	4,636,063,419
Pjesa afatgjate:				
Hua bankare ndaj IBA - pjesa afatgjate	8%	3 vjet	2,463,118,252	6,176,714,566
Hua ndaj ARMO	0%	pa afat	310,682,608	322,888,695
Hua ndaj te treteve	0%	pa afat	718,175,000	714,820,000
			3,491,975,860	7,214,423,261
Totali			12,458,696,996	11,850,486,680

8. Detyrime per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar me 31 dhjetor 2013 jane si me poshte:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Te pagueshme ndaj te treteve	7,547,327,739	7,065,323,166
Te tjera te pagueshme	350,488,784	348,963,833
Totali	7,897,816,523	7,414,286,999

9. Kosto e punes

Kostoja e punes per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013 eshte 1,938,706 Leke, e cila perfshin kontributet shoqerore dhe shendetesore si dhe tatimin mbi te ardhurat personale.

10. Shpenzime interesi dhe komisioni, neto

Shpenzime interesi dhe komisioni, neto, per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
Interesa ndaj IBA	(624,119,843)	(200,675,398)
Interesa per pagesa te vonuara ndaj IBA	(439,039,376)	(32,116,500)
Komisione bankare	(30,710)	(95,370)
Shpenzime financiare, neto	(1,063,189,929)	(232,887,268)

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

11. Fitime nga kurset e kembimit, neto

Fitime nga kurset e kembimit, neto, per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
Fitime te realizuara nga kursi i kembimit	98	426
Fitime te parealizuara nga kursi i kembimit	-	59,662,410
	98	59,662,836
Humbje te realizuara nga kursi i kembimit	(278)	(115)
Humbje te parealizuara nga kursi i kembimit	(28,360,294)	(363,770,892)
	(28,360,572)	(363,771,007)
Fitime nga kembimi, neto	(28,360,474)	(304,108,171)

12. Tatim-fitimi

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin eshte 10%.

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe organet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin perfundimtar. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Rakordimi i normes efektive te tatim-fitimit:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	%	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012	%
Fitimi (humbja) para tatimit	(8,733,166,559)		(537,549,120)	
Tatim-fitimi me normen standarde	(873,316,656)	10%	(53,754,912)	10%
Rregullimet e bazes se tatueshme:				
Shpenzimet e interesit te huase	62,411,984	-1%	20,067,540	-4%
Shpenzimet e interesit per pagesa te vonuara	43,903,938	-1%	3,211,650	-1%
Zhvleresimi i investimit	763,967,745	-9%	-	0%
Te tjera shpenzime	-	0%	55,368	0%
Tatim-fitimi (humbja tatimore)	(3,032,989)	0%	(30,420,354)	6%

Gjate vitit 2013, Shoqeria nuk eshte angazhuar ne aktivite fitimpruese, duke rezultuar keshtu ne humbje kontabel. Bazuar ne Ligjin 8438, 28 dhjetor 1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" (te ndryshuar), shpenzimet e interesit, perfshire dhe interesin per pagesa te vonuara, konsiderohen si shpenzime te pazbritshme per qellime te tatim fitimit nese raporti hua:kapitale te veta tejkalon raportin 4:1, ose nese shuma e kapitaleve te veta eshte negative. Meqenese me 31 dhjetor 2013 Shoqeria rezulton me kapitale te veta negative, shpenzimet e interesit, perfshire edhe interesin per pagesa te vonuara, i jane zbritur humbjes kontabel. Referuar te njejt ligj, provigjonet per zhvleresime jane shpenzime te pazbritshme per qellime te tatim fitimit. Provigjoni per zhvleresimin e investimit ne kapitalin e ARMO sh.a. i jane zbritur humbjes kontabel.

Humbjet fiskale mund te mbarren deri ne 3 vite. Bazuar ne Ligjin 8438, 28 dhjetor 1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" (te ndryshuar), humbjet fiskale te vitit 2013, si dhe ato te mbarura nga vitet e meparshme nuk

Anika Mercuria Refinery Associated Oil sh.a.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

(shumat ne Leke)

mund te mbarten ne periduhat e ardhshme per shkak te ndryshimit te struktures se pronesise se Shoqerise me me shume se 50% ne 6 gusht 2013. Si rrjedhim, humbjet fiskale te mbartura me 31 dhjetor 2013 jane zero.

13. Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2013, Shoqeria nuk ka çështje apo pretendime qe do te kene efekt negativ ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 dhjetor 2013, Shoqeria nuk ka angazhuar kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

14. Palet e lidhura

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013, nuk ka transaksione apo balanca me pale te lidhura, me perjashtim te drejtimit kryesor, qe perfaqesohet nga administratoret. Shuma e pagueshme ndaj administratoreve per punen e bere eshte si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2012
Paga	1,526,978	-
Tatim mbi te ardhurat personale	75,000	-
Kontribute shoqerore dhe shendetesore	128,625	-
	1,730,603	-

15. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.